



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: Bashkimit të operatorëve ekonomikë “INSTITUTI DEKLIADA-ALB” shpk & “ARENA MK” shpk

Adresa: TIRANE Rruga Donika Kastrioti, pallati Teknoprojekt, apartamenti 9/1, 1001;
Fier Qender-MALLAKASTER DUKAS Rruga Nacionale Ballsh-Fier, Ndertesa private Nr.2, Zona kadastrale 1566, Nr.pasurie 93/14.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **Loti IV:** “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rikonstruksion i bllokut të kufizuar nga rrugët “Ali Baushi”-“Arben Minga”-“Kongresi i Manastirit”-“Ibrahim Brahja”-“Xhanfize Keko”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-55495-12-29-2022.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Loti IV:** “Mbikqyrja e punimeve për objektin “Rikonstruksion i bllokut të kufizuar nga rrugët “Ali Baushi”-“Arben Minga”-“Kongresi i Manastirit”-“Ibrahim Brahja”-“Xhanfize Keko”.

Fondi limit: **865,445.03** (tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e dyzetë e pesë pikë zero tre) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 8 (tetë) muaj kalendarik.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Nr.14, datë 13 Shkurt 2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “C.E.C GROUP” sh.p.k NUIS L11807013M

Vlera e ofertës: 705,121 (shtatëqind e pesë mijë e njëqind e njëzet e një) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “FTA STUDIO” shpk & “ZENIT&CO” shpk

NUIS: L72411026N; K61731002D

Vlera e ofertës: 745,830.90 (shtatëqind e dyzet e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “INSTITUTI DEKLIADA-ALB” shpk & “ARENA MK” shpk

NUIS K71606006A; L67619801Q

Vlera e ofertës: 745,830.90 (shtatëqind e dyzet e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “MCE” sh.p.k. & “STATENG” shpk

NUIS: L72203065K; L98819501J

Vlera e ofertës: 745,830.90 (shtatëqind e dyzet e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Novatech studio” shpk

NUIS: L01717030C

Vlera e ofertës: 745,830.90 (shtatëqind e dyzet e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “DERBI-E” shpk & “Studio Service D&S” shpk

NUIS: K77916947A; L71305518R

Vlera e ofertës: 757,740 (shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë eshtatëqind e dyzet) lekë pa TVSH.

7. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “SPHAERA” shpk & “ARCHISPACE” shpk

NUIS: J81809003U; L42403012A

Vlera e ofertës: 772,622 (shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “C.E.C GROUP” sh.p.k

NUIS L11807013M

Operatori ekonomik “C.E.C GROUP” shpk, nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në shtojca 8, Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta për kualifikim ku përcaktohet: "Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, pasi vlera e ofertës është më e ulët se vlera minimale e perlogaritur per kete procedurë prokurimi sipas VKM 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim".

2. Operatori ekonomik “Novatech studio” shpk

NUIS L01717030C

Operatori ekonomik Instituti “Novatech studio” ka deklaruar 12 (dymbëdhjetë) punonjës nga 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të kërkuar në DST gjë e cila bie në kundërshtim me pikën 3 të kriterëve të veçanta për kualifikim ku citohet se: Një punësim mesatar i të paktën 15 personave, për periudhën të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave...

3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “FTA STUDIO” shpk & “ZENIT&CO” shpk

NUIS: L72411026N; K61731002D

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “FTA STUDIO” shpk & “ZENIT&CO” shpk nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion provues. Për rrjedhojë nuk përmbush kërkesat sipas pikës 6, neni 26, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëjësuar me origjinalin”.*

4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “MCE” sh.p.k. & “STATENG” shpk

NUIS: L72203065K; L98819501J

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “MCE” sh.p.k. & “STATENG” shpk nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion provues. Për rrjedhojë nuk përmbush kërkesat sipas pikës 6, neni 26, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëjësuar me origjinalin”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *Bashkimin e operatorëve ekonomikë “INSTITUTI DEKLIADA-ALB” shpk & “ARENA MK” shpk*, me adresë: TIRANE Rruga Donika Kastrioti, pallati Teknoprojekt, apartamenti 9/1, 1001; Fier Qender-MALLAKASTER DUKAS Rruga Nacionale Ballsh-Fier, Ndertesa private Nr.2, Zona kadastrale 1566, Nr.pasurie 93/14, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 745,830.90 (*shtatëqind e dyzet e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë pikë nëntëdhjetë*) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor, Bashkia e Tiranës*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 757,740 (*shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë eshtatëqind e dyzet*) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO